



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEQA"

Nr. Protokolit:	141/ 10.06.2024
Për:	Prof.dr.Edmond Beqiri-Prorektor për cilësi dhe bashkëpunim ndërkombëtar Msc.Gentiana Kastrati-Drejtoreshë për cilësi
Kopje :	Prof.asoc.HysenNimani-Dekan i Fakultetit të Arteve
Nga:	Grupi punues për vlerësim të programit Edukim artistik në interpretim
Lënda:	Vlerësimi i programit të studimit /Programi Edukim në muzikë - Bachelor

Raport mbi vlerësimin e programit Edukim artistik në interpretim /Fakulteti i arteve

Duke u bazuar në Rregulloren për programe të studimit dhe Udhëzuesit për vlerësimin e programeve të studimit ,Komisioni Ad-hoc për vlerësimin e programeve ka pranuar dokumentacionin nga bartësit e programit Edukim artistik në interpretim me çrast është bërë analiza e programit .

Misioni i programit Edukim artistik në interpretim

Misioni i programit Edukim Artistik ne Interpretim ka per qellim edukimin për njohuri të thella akademike dhe aftësi të larta që lidhen me lëmin e muzikës, si dhe për të zhvilluar kapacitetet superiore të nevojshme për punë krijuese.Programi EAI është qendër e edukimit artistik, pedagogjik dhe profesional, që përgatitë student konkurues për tregun e punës,që do të kontribuojnë në zhvillimin e gjithmbarshëm të shoqërisë.

Qëllimi kryesor i programit “Edukim Artistik ne Interpretim” është ngritja e cilësisë pedagogjike muzikore dhe formimi profesional i studentëve pas përfundimit të studimeve ushtrojnë veprimtarinë e pedagogjisë dhe artit përformues, në instrumentin qe kane perzgjedhur studentet.Gjithashtu me kete program do të ngritët niveli i pedagogëve instrumentist.

Qasja artistike në këtë drejtim ka për qëllim shtjellimin e metodave bashkëkohore të punës pedagogjike. Planprogrami është i dizajnuar për studentët për të vlerësuar ndikimin e aktiviteteve njerëzore mbi Fushën Teorike/Pedagogjike, për të balancuar nevojat sociale dhe ekonomike me realitetin aktual. Studentët do të fitojnë njohuri dhe shkathtësi pedagogjike dhe hulumtuese në muzikë. Programi i studimit ka një koncept të mire-përcaktuar didaktik dhe kërkimor.

Rezultatet e të nxënit :

- Të ekzekutoj si solist;
- Të jetë anëtar/Instrumentalist në orkestra muzikore;
- Solist dhe anëtar i muzikës së dhomës dhe ansambleve tjera muzikore;
- Edukimin nxënësve në instrumente frymore, instrumente me harqe dhe tela, Piano, Kitare , Solokëndim dhe muzikë të dhomës në shkollë të ulët të muzikës dhe shkollë të mesme të muzikës;
- Kryerjen e hulumtimeve profesionale në fushën e instrumente frymore, instrumente me harqe dhe tela, Piano , Solokëndim dhe ekzekutimin artistik;
- Udhëheqjen e formacioneve të ndryshme instrumentale frymore amatore apo profesionale;
- Të jetë anëtare e koreve profesionale .
- Kryerjen e të gjitha veprimtarive dhe aktiviteteve për të cilat kërkohet shkollë e lartë e muzikës,

përfshirë edhe si udhëqës të departamentit në sesionin e frymore, instrumente me harqe dhe tela, Piano , Solokëndim.

VLERËSIMI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË EKSPERTËVE

(Të vlerësohet nëse rekomandimet e dhëna nga ekspertët ndërkombëtar janë implementuar)

Bartësit e programit studimor Edukim Artistik në interpretim , bëjnë vlerësimin sistematik të ecurisë së programit duke përfshirë fushat kyçe si: menaxhimin e cilësive, administrimin, stafin akademik, procesin mësimor, angazhimin dhe punën e studentëve, zhvillimet infrastrukturore si dhe hulumtimet (aktivitete artistike) nga studentët dhe stafi akademik.

Rishikimi dhe implementimi i rekomandimeve nga ekspertët ndërkombëtarë mbi programin në fjalë realizohet në bazë të rregullta, me ç'rast në rishikimin e fundit është konstatuar se nga gjithsej 34 rekomandime që janë dhënë në ri akreditimin e programit EAI të vitit 2022,

20 sosh apo 85 % janë të përfunduara ose në proces 2021-2024, 4 prej tyre apo 15% janë te papërfunduara.

Rekomandimet te cilat jane ne proces te implemtimit jane kryesisht procese te cilat realizohen nga njeri vit akademik ne tjetrin si: procedurat e treguesve te sigurimit te cilësisë, konceptet hulumtuese, digjitalizimi i sistemit te vlerësimit, format e vlerësimit te performances se profesorëve, pasurimi i materialeve mësimore, monitorimi i praktikës se studenteve, bashkëpunimi institucional.

Rekomandimet te cilat nuk jane realizuar jane ato ku ka kërkesë per trajnime te caktuara si: trajnime per këshillim te studenteve dhe trajnim per metodologjinë e mësimdhënies per persona me aftësi te veçanta.

Trajnimet ne Uhz organizohen nga Qendra e ekselences dhe si vazhde e kësaj presim ne te ardhmen te përfitojmë si staf nga kërkesat ne fjale dhe zbatimin e tyre nga organet kompetente.

EVIDENTIM TË PJESËMARRJES SË STUDENTËVE NË LIGJËRATA

(Të vlerësohet duke krahasuar numrin e studentëve të regjistruar në program me numrin e studentëve pjesmarrës në ligjerata dhe ushtrime)

Duke u bazuar në Rregulloren për studime themelore si dhe duke u bazuar në vendimin e Këshillit të Fakultetit ,studentët në Fakultetin e arteve për shkak të natyrës dhe specifikave të mësimit kanë të drejtë mungese deri në tri herë ,andaj studentët sipas listës së prezencës kanë vijueshmëri aktive gjatë ligjëratave.

KALUESHMËRIA E STUDENTËVE

(Analizoni kalueshmërinë për secilën lëndë dhe programin në përgjithësi, evidentoni shkallën me të ulët dhe me të lartë të kalueshmërisë)

Duke u bazuar në statistika të kalueshmërisë së provimeve për vitin akademik 2022-2023 kalueshmëria e provimeve më e ulët është në vitin e parë me 81.18% ndërsa kalueshmëria e provimeve më e larta paraqitet në vitin e katërt me 100%.

	Numri i atyre që e kanë paraqitur provimin	Numri i atyre që kanë abstenuar- ose nuk kanë hyrë në provim	Numri i atyre që kanë hyrë në provim	Numri i atyre që nuk e kanë kaluar provimin	% në raport me ata që iu kanë nënshtruar provimit	Numri i atyre që e kanë kaluar provimin	% në raport me ata që iu kanë nënshtruar provimit
Totali i vitit të I	105	20	85	15	17.67	69	81.18
	Numri i atyre që e kanë paraqitur provimin	Numri i atyre që kanë abstenuar- ose nuk kanë hyrë në provim	Numri i atyre që kanë hyrë në provim	Numri i atyre që nuk e kanë kaluar provimin	% në raport me ata që iu kanë nënshtruar provimit	Numri i atyre që e kanë kaluar provimin	% në raport me ata që iu kanë nënshtruar provimit
Totali i vitit të II	13	1	12	0	0.00	12	100.00
	Numri i atyre që e kanë paraqitur provimin	Numri i atyre që kanë abstenuar- ose nuk kanë hyrë në provim	Numri i atyre që kanë hyrë në provim	Numri i atyre që nuk e kanë kaluar provimin	% në raport me ata që iu kanë nënshtruar provimit	Numri i atyre që e kanë kaluar provimin	% në raport me ata që iu kanë nënshtruar provimit
Totali i vitit të III	29	2	27	1	3.70	24	88.89
	Numri i atyre që e kanë paraqitur provimin	Numri i atyre që kanë abstenuar- ose nuk kanë hyrë në provim	Numri i atyre që kanë hyrë në provim	Numri i atyre që nuk e kanë kaluar provimin	% në raport me ata që iu kanë nënshtruar provimit	Numri i atyre që e kanë kaluar provimin	% në raport me ata që iu kanë nënshtruar provimit
Totali i vitit të IV	7	0	7	0	0.00	7	100.00

VLERËSIM TË SYLLABUSËVE

(Analizoni syllabuset e lëndëve për të parë nëse janë të strukturuar në mënyrë efektive, a janë përditësuar në dy vitet e fundit dhe a përfshijnë informacionin e nevojshëm për studentët)

Rishikimi i syllabuseve behet cdoherë në fillim të semestrit, të cilat rifreskohen me literature të re nëse ka, shtohen dhe aktivitetet artistike, punimet shkencore ose ndërrimet e ndonjë teme të ligjeratave.

Te gjithë syllabuset e rishikuara dërgohen për publikim në web dhe kanë qasje të gjithë të hapin.

Në vitin akademik 2022-2023 në Këshillin e Fakultetit është marrë vendim se tek tabelarja e ngarkesës së studentit të shtohen më shumë pikë në aktivitete, ky ndryshim është involvuar sipas kërkesës së ekspertëve të jashtëm.

VLERËSIM TË LITERATURËS SË PËRDORUR, MUNGESAT E VËREJTURA DHE MASAT PËR PËRMIRËSIM TË SITUATËS;

(Siguroni nëse literatura dhe burimet e përdorura në program ekzistojnë, është bashkëkohore dhe jo më e vjetër se dhjetë vite, dhe identifikoni mangësitë gjatë këtyre viteve)

Komisioni për verifikim të literaturës në Bibliotekë të Universitetit ka verifikuar titujt ekzistues për programin Edukim artistik në interpretim si dhe mungesat eventuale të literaturës për këtë program.

Pas këtij raporti me kërkesë nga menaxhmenti në vitin 2022 janë siguruar edhe 12 libra.

Për më tepër, ne shfrytëzojmë edhe bibliotekat online me universitetet që kemi bashkëpunime institucionale.

REGJISTRIMI I STUDENTËVE NË RAPORT ME NUMRIN E SHPALLUR PËR APLIKIM, DHE FORMAVE TË TJERA, VARËSISHT NGA PROGRAMI I VLERËSUAR

(krahasoni numrin e shpallur për aplikim me numrin e studentëve që kanë aplikuar dhe numrin e të regjistruarve).

Programi Edukim artistik në interpretim është riakredituar në vitin akademik 2022/2023 dhe pranohen 20 studentë :

Numri i aplikantëve në vitin 2022/2022 : Aplikuan : 12, Të pranuar :9 .

Numri i aplikantëve në vitin 2023/2024 : Aplikuan : 12, Të pranuar : 5.

VLERËSIM TË SHPËRNDARJES SË KREDIVE NËPËR LËNDË

(Vlerësoni se si janë kalkuluar kreditë për secilën lëndë duke llogaritur ngarkesën e studentëve për këto lëndë/program)

Duke u bazuar në formën e mësimit në Fakultetin e arteve ,ligjëratat mbahen në formë kolektive,grupore dhe individuale.

Kredit janë të shpërndara sipas ngarkesës së studentit për lëndën e caktuar si p.sh. Ligjërata, Ushtrime vetanake ,koha e kaluar në provime dhe kollokuime, aktivitete etj.

Ngarkesa e studentit është 25 orë/1 kredi.

Specifikat e lëndës orientojnë ngarkesën e studentit si p.sh. lënda kryesore -instrumenti është lëndë individuale ku studenti ngarkesën e ka të ndarë në ushtrime individuale në shtëpi , një pjesë me pjesëmarrje në koncerte dhe me punën në ligjërata, Orkestër është lëndë kolektive e cila gjithë ngarkesën e studentit e orienton në ligjëratë ,lënda Histori muzike studenti ngarkesën e orienton në mësim, ligjëratë dhe hulumtim etj.

VLERËSIM TË LËNDËVE MËSIMORE

(Bëni vlerësimin e lëndëve të programit duke krahasuar se a përputhen me rezultatet e të nxënësve dhe si ndihmojnë tek studentët në zhvillimin, aftësimin dhe arritjen e njohurive të tyre. Siguroni nëse janë marrë parasysh kërkesat e tregut)

Ne kuadër të programit EAI , çdo vit të ri akademik bëhet rifreskimi i syllabusëve si kërkesë permanente , e cila del si e nevojshme në analizën si proces i një viti paraprak nga profesori i lëndës gjithnjë duke u bazuar në qëllimet dhe objektivat e lëndës si kriter për zbatimin e njohurive të reja të studentit . Syllabuset pas dorëzimit konform rregullave, dorëzohen tek koordinatori për cilësi dhe tek bartësit e programit . Gjithashtu kontrollohen edhe nga bartësit e programit duke dhënë edhe sygjerimet e tyre (nëse është e nevojshme) .

Në një vit akademik ,për të verifikuar njohuritë e fituara në bazë të planprogramit, studenti kalon në disa etapa vlerësimi siç janë : prezenca në ligjerata, kolokuiumet , provimet , puna praktike , koncertet , ushtrimet ,etj. Nga ky proces , në bazë të rezultateve të dala , profesori i lëndës bën analizë të përgjithshme përmes së cilës krijohet një pasqyrë reale për të arriturat apo edhe ngecjet . Studentët nga ana e tyre , përveç kontaktit me profesorin gjatë ligjëratave apo ushtrimeve kanë edhe mundësi të tjera të komunikimit si psh . ditët e caktuara për konsultime të rregullta javore me secilin profesor (orari është praktikë edhe e disa viteve të mëhershme , përveç kohës pandemike, orari publikohet) . Monitorimi i ardhjes me rregull si për studentët ashtu edhe për profesorin bëhet përmes nënshkrimit në listën e prezencës dhe kartelës së TIK – ut si metodë e re në dy vitet e fundit . Secili student i regjistruar dhe secili profesor është i pajisur me kartelen personale të TIK- ut ku evidentohet çdo ligjëratë e mbajtur.

VLERËSIM TË ELEMENTËVE TJERA (LIGJERATA, PUNIME SEMINARIKE, PRAKTIKA, PROJEKTE, LABORATORË, ETJ)

(Vlerësoni se si elementët e cekura të programit kontribuojnë në zhvillimin e studentëve, a marrin pjesë studentët projekte, punë praktike....

Studentët janë shumë aktiv në konferenca, koncerte, aktivitete me konkurse garuese ,aktivitete brenda dhe jashtë vendit, këto që zhvillojnë dhe formësojnë studentin për skenë si dhe për ngritjen e nivelit për shkrime të punimeve etj.

Aktivitetet e studentëve gjatë viteve :

Nga 2022- 2024 studentët e programit Edukim Artistik në Interpretim kanë marrë pjesë në koncerte të shumta në

Kosovë dhe në vende tjera rajonale dhe europiane, vlen të theksohet bashkëpunimi me instrumentist tonë me Filharmoninë e Kosovës në Prishtinë ,pjesëmarrje në koncert dhe gara ndërkombëtare Kroaci ,Maqedoni, Shqipëri si dhe nëpër të gjitha qytetet e Kosovës,pjesëmarrje në festivalin e gitareve ,pjesëmarrës në konkurs garues në Orkestrën simfonike të projektit që realizohet nga Bashkimi europian koncert i mbajtur në Tiranë 9 maj 2024.

Pjesëmarrje e studentëve për punën praktike në shkolla fillore dhe të mesme ,pjesëmarrja në masterklas me profesor eminent jashtë universitetit dhe brenda. Gjithashtu dhe puna me artist të ftuar ka rëndësinë për praktika dhe teknika të reja që formësohet studenti si artist. Pjesëmarrja në tryeza të rrumbullakta për involvimin e këngës shqipe. Fitues të çmimeve të para në gara ndërkombëtare, aktivitetet të rregullta si paraqitje skenike për javën studentore në qytete të ndryshme të Kosovës ,studentët në mobilitet për një semestër me anë të projektit Erasmus në Universitetin e Osjekut në Kroaci, etj.

Ngritje tjetër ku në lëndën menaxhim i projekteve përgatiten për formën e aplikimit dhe punën se si përpilohet një projekt, vlen të theksohen koncertet solistike si dhe koncertet e hapura të mbrojtjes së diplomave !

Secili instrumentist se paku një herë në semester është i obliguar të ketë paraqitje para publikut ,etj.

**VLERËSIM TË IMPLEMENTIMIT TË PROGRAMIT DHE PLANPROGRAMIT TË STUDIMIT NË VITET
PËRKATËS AKADEMIK;**

(Të vlerësohet si është implementuar programi dhe planprogrami në vitet akademik përkatës, monitoroni përmbushjen e objektivave dhe a është zhvilluar sipas orarit programi)

Programi është implelementuar sipas specifikave përkatëse që ka si ligjërata kolektive, grupore dhe individuale poashtu dhe me punë praktike .Gjatë këtyre dy viteve janë organizuar një numër i madhe i aktiviteteve si koncerte ,gara, masterklase. Gjatë vitit 2022/23 janë organizuar koncerti i 10 vjetorit të themelimit të Fakultetit të arteve, koncert për ditën e flamurit, koncert për ditën e pavarësis, Java artistike studentore,4 student në Saksofon kanë marrë pjesë në gara ndërkombëtare Pjetër Gaci në Shkodër dhe kanë fituar Çmimin e parë ,dhe të dytë ,tri masterklase në Flaut ,Klarinetë dhe Solokëndim,dy koncerte bashkëpunim me FSK-në. Gjatë vitit 2023/24 aktivitete 5 koncerte janë realizuar si Java artistike në lëvizje edicioni i 6-të në Pejë,Prizren,Gjakovë,Tiranë,Prishtinë,dy masterklase një në kitarë dhe një në Piano,4 studentë 2 Saksofon,1 Kitare,1 Solokëndim pjesëmarrës në Gara ,fitues të çmimit të parë dhe një fitues i vendit të tretë në natën finale të çmimit absolut.

**VLERËSIM I FEEDBACK-UT TË MARRË NGA VLERËSIMI I BËRË ME STUDENTË, PUNËDHËNËS,
INDUSTRIË ETJ**

(Mblidhni informacione dhe vlerësime nga studentët, punëdhënësit dhe industrinë për programin dhe vlerësoni ato rezultate).

Sipas pyetësorëve që bartësit e programit kanë realizuar me drejtorët e shkollave të muzikës dhe Drejtorët e institucioneve kulturore kemi ardhë në përfundim se në Komuna në tri vitet e fundit në Shkolla të muzikës publike dhe private në Kosovë 84.6% e mësimdhënësve janë të padiplomuar ,vetëm 53% e Shkollave kanë Kor, Orkestër, Ansambël dhe 100% e të gjitha shkollave të muzikës mendojnë se kanë nevojë ende për instrumentist të kualifikuar. Në bazë të pyetësorëve për vlerësim nga studentët rezultati më lartë është 4.88 ndërsa rezultati më i ulët është 4.68 . Nga këto të dhëna vërejmë një trend pozitiv të vlerësimit të studentëve për mësimdhënie interaktive ,trajtim të temave sipas sylabusit dhe planprogramit.